

PERSHKRIMI I NDRYSHIMIT TE PROJEKTIT

POZICIONI GJEOGRAFIK:

- Kaskada e 2 hidrorcentraleve mbi Lumin Kuç ndodhet në pjesën e sipërme të Lumit Shushica, pranë Fshatit Kuç apo rreth 11 km në veri perëndim të Himarës.
- Rruga e aksesit për të shkuar në projekt është rruga Vlore- Drashovicë e cila pothuaj kalon përgjatë rrjedhës së Lumit Shushicë.
- Skema e re e hidrocentraleve bazohet në ndërtimin e 2 hidrocentraleve.

Në këtë material trajtohet shfrytëzimi i rrjedhës së sipërme ujore të Lumit Shushicë, nga kuota +512 deri në kuotën +327 (Ura e Laskos) përmes ndërtimit të dy Hidrocentraleve të vegjël, variant ky që po kryhet në kuader të studimeve të thelluara në zbatim të Miratimit Paraprak lëshuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

Edhe në këtë version mbeten në konsideratë raportet hidrologjike, matjet topografike, Studimet gjeologjike të shqyrtuara edhe në variantet e trajtuara më parë sidomos në variantin me një HC në kuotën 345 m, i cili u punua edhe në faze projekt zbatimi por që u anulua si jo fisibël, për shqetësime në ambient etj.

Adresa: Lagjja Spile, Pallati Maraç, Kati I-re, Bashkia Himare

Tel: +355 69 20 90 725

Email: info@agegroup.al

AGE- Kuç Shpk

Sipas këtij varianti, do ndërtohen 2 hidrocentrale të vegjël.

Po kështu në këtë studim do të shfrytëzohen jo vetëm hartat 1 :25 000 por edhe relievi topografik i punuar gjatë varinti të parë e cila rri shkallën e sigurisë për vlerësimin serioz të këtij variant.

Ndryshimi i Skemes se HC-eve dhe spostimi i ndertesës se hidrocentralit nga kuota 345m ne kuoten 327 m, behet per keto arsye dhe ka keto avantazhe :

- ✦ Impakti ne mjedis sipas ketij varianti eshte thelbesisht me i reduktuar;
- ✦ Nderhyrjet ne terren sipas ketij varianti jane minimale;
- ✦ I gjithe projekti pothuaj ndjek rrugen rurale pergjate shtratit te proit te Shurit mbi Fshatin Kuç dhe rrugen rurale poshte Fshatit Kuç;
- ✦ Sipas ketij variati rritet edhe me shume shkalla e fisibilitetit te Projektit.
- ✦ I gjithe projekti nuk kalon neper kodra apo shpatet e thepisura te Fshatit Kuç dhe kjo eshte tejet pozitive ne çdo aspekt.
- ✦ Devijimi i ujit sipas ketij varianti eshte tejet minimal dhe nuk ka te krahasuar per nga pozitiviteti me variantin e pare me nje hidrocentral.
- ✦ Koha e ndertimit te ketij projekti eshte me e shkurte dhe kjo redukton levzjet me mjete te renda, zhurmat ne zone gjate kohes se ndertimit etj.
- ✦ Aksesi ne rruge dhe ne linjat ekzistuese elektrike eshte i gatshem.

VENDNDODHJA e HC1.

Vepra e marrjes se ketij HC do te jete ajo e percaktuar me pare ne kuoten +515m e cila perkon me fillimin e kanalit vadites ekzistues te ndertuar ne Vitet 1962-1968.

Uji do te futet ne nje tubacion celiku te vendosur anash shtratit te lumit (ne pozicione te pershtatshme dhe te mbrojtura) per rreth 2000 ml duke vijuar deri tek Ndertesa e HC1 e cila do te pozicionohet prane zallishteve ne shtratin e Lumit ne kuoten 405m.


Ndertesa do te jete prane burimeve qe dalin ne anen e lumit prane fshatit me kuote absolute +410 m, pikerisht ne ne ane e majte te derdhjes se perroit te thate ne lume.

VENDNDODHJA e HC2.

Vepra e Marrjes se HC2 do te ndertohet afersisht ne distancen 100 ml me poshte Vepres se Marrjes ekzistuese tek Buronjat, ne kuoten 403 m mbi nivelin e detit. Ajo do te kompletohet edhe me nje dekantues dhe nje pusete e cila do te dergoje gjithë prurjen e grumbulluar nepermjet je sifoni me tubacion celiku deri ne Ndertesën e HC 2 ne kuoten 327 m mbi nivelin e detit dhe me nje gjatesi totale prej 3200 ml.

Ndertesa do te jete prane Ures se Laskos ne taracen lumore e krijohet nga derdhja e perroit qe shoqeron rrugen e re e cila vjen nga Himara ne krahun e majte te rrjedhes se lumit. Distanca para se te shkosh tek Ura eshte afersisht 150 ml.

Ky pozicion eshte mjaft i pershtatshem per ndertimin e HC2 dhe derdhjen e ujrave nga kanali i shkarkimit mbasi te gjithë ujrat e nje pellgu ujembledhes prej 64,8 km² mblidhen ne kete pozicion.



PARAMETRAT ENERGJITIK TE HIDROCENTRALEVE:

▪ Hidrocentrali Nr.1:

- Prurja llogaritese 1.80 m³/sek
- Gjatesia e tubacionit 2100 m
- Diametri mesatar 1200 mm
- Niveli i ujit vepra marrjes 512 m
- Aksi i turbinave 405 m
- Lartesia Bruto 107 m
- Lartesia neto 99.7m

▪ Hidrocentrali Nr.2:

- Prurja llogaritese 2.70 m³/sek
- Gjatesia e tubacionit 3200 m
- Diametri mesatar 1500 mm
- Niveli i ujit vepra marrjes 403 m
- Aksi i turbinave 327 m
- Lartesia Bruto 76 m
- Lartesia neto 67.3 m

Adresa: Lagjja Spile, Pallati Maraç, Kati I-re, Bashkia Himare
Tel: +355 69 20 90 725
Email: info@agegroup.al

AGE- Kuç shpk

KORDINATAT MBI VENDODHJEN PER TE 2 HC-et JANE :

HC Nr.1

Kodrinatat e Vepres se marrjes Nr.1

Lartesia 512 m mbi nivelin e detit

ETRS89 19o 51' 7.7416" 40o 11' 42.1051"

UTM Zone 34N 402298.12 4450035.59

Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4 4402389.68 4451946.55

KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator 487410.55 4451194.87

Kordinatat e Ndertese se Centralit Nr.1

Lartesia 405 m mbi nivelin e detit

ETRS89 19o 50' 6.7932" 40o 11' 0.2665"

UTM Zone 34N 400840.12 4448764.36

Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4 4400931.08 4450674.81

KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator 485966.54 4449906.94

HC Nr.2

Kodrinatat e Vepres se marrjes Nr.2

Lartesia 403 m mbi nivelin e detit

ETRS89 19o 50' 11.9688" 40o 10' 59.4993"

UTM Zone 34N 400962.20 4448739.10

Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4 4401053.22 4450649.54

KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator 486088.94 4449883.05

Kordinatat e Ndertese se Centralit Nr.2

Lartesia 327 m mbi nivelin e detit

ETRS89 19o 48' 25.5988" 40o 10' 52.6533"

UTM Zone 34N 398443.88 4448561.40

Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4 4398533.88 4450471.76

KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator 483572.08 4449676.94

Ky ishte informacioni shtese per kete variant te ri i cili do te zbatohet.

Ritheksojmë edhe një herë që ndikimit e kësaj vepre në mjedisi do të jenë minimal dhe brenda normave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi duke patur parasysh që edhe kapaciteti i HeC është nën 2 MW, i cili nuk është as objekt konçensionin, por miratohet nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë.

Gjithshtu ju bëjmë me dije se Shoqëria jonë ka marrë miratimin paraprak të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për ndërtimin e projektit hidroteknik të KUÇ-it, me datë 07.12.2015, me nr.prot. 4419/8 (të cilën e kemi paraqitur në dosjen e aplikimit) dhe nga OSHEE opinionin paraprak mbi lidhjen e HeC Kuç me sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike me 26.10.2015, me nr.prot. 19342/1 (të cilën e kemi paraqitur në dosjen e aplikimit).

Nga sa më sipër, duke parë dhe ndimet e pakëta që do ketë kjo vepër në mjedis dhe duke theksuar faktin që ky projekt është miqësor ndaj Mjedisit dhe shoqëria jonë angazhohet për të mbrojtur të gjithë

Adresa: Lagjja Spile, Pallati Maraç, Kati I-re, Bashkia Himare

Tel: +355 69 20 90 725

Email: info@agegroup.al